

V E N D I M

Nr. 823, datë 30.12.1998

PËR DHËNIE NDIHME FINANCIARE DISA FAMILJEVE TË DËMTUARA

Në mbështetje të ligjit nr. 8283, datë 3.2.1998 “Për buxhetin e shtetit të vitit 1998” dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 206, datë 26.3.1998 “Për kriteret e pjesëmarrjes së shtetit në përballimin e dëmeve, në raste fatkeqësish”, me propozimin e Ministrisë së Pushtetit Lokal, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Komunës Portez, në rrethin e Fierit, në buxhetin e miratuar për vitin 1998, i shtohen 503 776 (pesëqindetë mijë e shtatëqindeshtatëdhjetegjashtë) lekë për dhënie ndihme z. Pajtim Muhedin Malaj. Ky fond të përdoret në masën 423 776 (katërqindënjëzetetë mijë e shtatëqindeshtatëdhjetegjashtë) lekë për blerje banese dhe 80 000 (tetëdhjetë mijë) lekë për blerje pajisjesh dhe orendish.

2. Ngarkohet komuna Portez të kontrollojë përdorimin e këtij fondi për destinacionet e përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi.

3. Komunës Greshicë, në rrethin e Mallakastrës, në buxhetin e miratuar për vitin 1998, i shtohen 220 000 (dyqindënjëzet mijë) lekë për dhënie ndihme z. Skënder Haxhi Lamaj, banues në fshatin Greshicë. Ky fond të përdoret në masën 120 000 (njëqindënjëzet mijë) lekë për riparimin e banesës dhe 100 000 (njëqind mijë) lekë për blerje pajisjesh dhe orendish.

4. Ngarkohet komuna Greshicë të kontrollojë përdorimin e këtij fondi për destinacionet e përcaktuara në pikën 3 të këtij vendimi.

5. Ngarkohet prefektura e Fierit të kontrollojë zbatimin e pikave 1,2,3 dhe 4 të këtij vendimi.

6. Komunës Mollas, në rrethin e Kolonjës, në buxhetin e miratuar për vitin 1998, i shtohen 233 965 (dyqindëtridhjetetë mijë e nëntëqindëgjashtëpesë) lekë për dhënie ndihme z. Etem Dalip Çausi, banues në fshatin Qafëzez. Ky fond të përballohet në masën 173 965 (njëqindeshtatëdhjetetë mijë e nëntëqindëgjashtëdhjetepesë) lekë për riparimin e ndërtesës dhe 60 000 (gjashtëdhjetë mijë) lekë për blerje pajisjesh dhe orendish.

7. Ngarkohet komuna e Mollasit të kontrollojë përdorimin e këtij fondi për destinacionet e përcaktuara në pikën 6 të këtij vendimi.

8. Komunës Drenovë, në rrethin e Korçës, në buxhetin e miratuar për vitin 1998, i shtohen 358 618 (treqindëpesëdhjetetë mijë e gjashtëqindetëmbëdhjetë) lekë për dhënie ndihme z. Mitro Petro Kaçi, banues në fshatin Mborje të kësaj komune. Ky fond të përdoret në masën 258 618 (dyqindëpesëdhjetetë mijë e gjashtëqindetëmbëdhjetë) lekë për riparimin e ndërtesës dhe 100 000 (njëqind mijë) lekë për blerje pajisjesh dhe orendish.

9. Ngarkohet komuna Drenovë të kontrollojë përdorimin e këtij fondi për destinacionet e përcaktuara në pikën 8 të këtij vendimi.

10. Ngarkohet prefektura e Korçës të kontrollojë zbatimin e pikave 6,7, 8 dhe 9 të këtij vendimi.

11. Bashkisë së Peqinit, në buxhetin e miratuar për vitin 1998, i shtohen 316 763 (treqindegjashtëmbëdhjetë mijë e shtatëqindegjashtëdhjetë) lekë për dhënie ndihme z. Myslim Hajrulla Kasa. Ky fond të përdoret në masën 276 763 (dyqindeshtatëdhjetegjashtë mijë e shtatëqindegjashtëdhjetë) lekë për riparimin e ndërtesës dhe 40 000 (dyzet mijë) lekë për blerje pajisjesh e orendish.

12. Ngarkohet bashkia e Peqinit të kontrollojë përdorimin e këtij fondi për destinacionet e përcaktuara në pikën 11 të këtij vendimi.

13. Komunës Gjergjan, në rrethin e Elbasanit, në buxhetin e miratuar për vitin 1998, i shtohen 407 760 (katërqindeshtatë mijë e shtatëqindegjashtëdhjetë) lekë për dhënie ndihme z. Hyqmet Myslim Çekrezi, banues në fshatin Gjergjan të kësaj komune. Ky fond të përdoret në masën 327 760 (treqindnjëzeteshtatë mijë e shtatëqindegjashtëdhjetë) lekë për blerje banese dhe 80 000 (tetëdhjetë mijë) lekë për blerje pajisjesh dhe orendish.

14. Ngarkohet komuna Gjergjan të kontrollojë përdorimin e këtij fondi për destinacionet e përcaktuara në pikën 13 të këtij vendimi.

15. Ngarkohet prefektura e Elbasanit të kontrollojë procedurat e zbatimit të pikave

11,12,13 dhe 14 të këtij vendimi.

16. Komunës Bujan, në rrethin e Tropojës, në buxhetin e miratuar për vitin 1998, i shtohen 364 330 (treqindegjashtëdhjetekatër mijë e treqindetridhjetë) lekë për dhënie ndihme z. Rasim Xhem Ahmetaj, banues në fshatin Gri të kësaj komune. Ky fond të përdoret në masën 264 330 (dyqindegjashtëdhjetekatër mijë e treqindetridhjetë) lekë për blerje banese dhe 100 000 (njëqind mijë) lekë për blerje pajisjesh dhe orendish.

17. Ngarkohet komuna e Bujanit të kontrollojë përdorimin e këtij fondi për destinacionet e përcaktuara në pikën 16 të këtij vendimi.

18. Ngarkohet prefektura e Kukësit të kontrollojë zbatimin e procedurave të pikave 16 dhe 17 të këtij vendimi.

19. Komunës Hajmel në rrethin e Shkodrës, në buxhetin e miratuar për vitin 1998, i shtohen 527 500 (pesëqindnjëzeteshtatë mijë e pesëqind) lekë për dhënie ndihme z. Pjetër Gjergj Prendi, banues në fshatin Nenshat të kësaj komune. Ky fond të përdoret në masën 427 500 (katërqindnjëzeteshtatë mijë e pesëqind) lekë për blerje banese dhe 100 000 (njëqind mijë) lekë për blerje pajisjesh dhe orendish.

20. Ngarkohet komuna Hajmel të kontrollojë përdorimin e këtij fondi për destinacionet e përcaktuara në pikën 19 të këtij vendimi.

21. Ngarkohet prefektura e Shkodrës të kontrollojë procedurat e zbatimit të pikave 19 dhe 20 të këtij vendimi.

21.Fondi prej 2.932.712 (dy milionë e nëntëqindetridhjetëdy mijë shtatëqindëdy mbëdhjetë) lekë të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko